



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal
Datë: 22.02.2024

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 22.02.2024 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e **II-të** (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: **29.02.2024**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 1-rë e Kuvendit Komunal.
2. Pyetje legjislativ të drejtuar ekzekutiv.
3. Propozim- Vendim për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Hydeajet Pireva B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës.
4. Propozim-Vendim për Themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal.
5. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik, -Lokal “Objekti Shtëpia Kulturës “Isa Kastrati”.
6. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik, -Lokal “Objekti Shtëpia Kulturës “Isa Kastrati”.
7. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës-SPMK Muçivërc.
8. Propozim- Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.7976
9. Të ndryshme.



Liridon KASTRATI
Kryesuesi i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e mbajtur më: 31.01.2024 dhe filloj ora 10:20. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Nënkrjetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Drejtori Njesisë së Auditimit të Brendshëm, përfaqësues nga zyra për Integritet Evropian, Shërbimi profesional i kuvendit, zyra ligjore, zyrtarja për barazi gjinore, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të "Bonevet", dhe media lokale. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit Komunal,
2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Propozim-vendim për miratim të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzimin afatgjatë për kompaninë "ISO RUBI" SH.P.K me procedurë të negocimit të ofertës,
4. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale(lokali ish" Shtëpia e Vjetër e Komunës"),
5. Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit nr.6569 i datës:04.03.2020,
6. Raporti i Kryetarit të Komunës për 6-të mujorin e dytë të punës për vitin 2023,
7. Informatë për Raportin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe planin e veprimit të Komunës së Kamenicës për vitin 2023,
8. Informatë për Raportin e Performancës Komunale për vitin 2022,
9. Shqyrtimi i raportit tremujor financiar Tetor-Dhjetor 2023,
10. Informatë për aktivitetin e KKS-së për vitin 2023,
11. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026,
12. Propozim-vendim për furnizim të fermerëve me mekanizëm bujqësor,
13. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, para se me filluar konstatojmë se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar seancën, nëse keni propozime shtesë fjala është për ju. **Labinot Haxhiu**-propozojmë që të fillojë procedura për dhënien në shfrytëzim përmes ankandit , fjala është për shfuqizimin e vendimit për " Bonevet" dhe për të njejtën pikë propozojmë që të zhvillohen procedurat përmes ankandit. Propozimi i dytë është që të financohet në tri vitete e ardhshme me nga 20 mijë euro

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- fillimisht e kemi propozimin për shfuqizim dhe të njëjtin e dërgojmë në MAPL për vlerësim 15 ditë e presim MAPL për përgjigje në rast se kthen MAPL-ja përgjigje ne jemi të obliguar për të filluar hapat për themelimin e saj. Ligjërish nuk kemi të drejt me vepruar në një pikë edhe propozimin për shfuqizim edhe edhe për themelim.

Labinot Haxhiu-ligjërish komuna ka të drejt mos me përfill MAPL-në pasi që MAPL është e obliguar që 15 ditë pas pranimit me kthyer komentim gjë që nuk e ka bërë, por për mos me u dokën që jemi bllokues ne e përkrahim këtë shfuqizim edhe me fut këtë fjali dhe prap se prap tem kryesore është shfuqizimi por me ju dhënë një garanci “ Bonevet” që komuna e Kamenicës nuk është e interesuar që me i larguar nga objekti i komunës.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ne kemi mbajtur takim edhe me “ Bonevet” me KPF dhe i kemi dhënë garancion dhe mbështetje të plotë nga gjitha subjektet që jemi për me i përkrah por të vazhdojë në bazë të rrugës ligjore.

Jeton Biqkaj-nëse e shfuqizojmë pronën që është duke e shfrytëzuar “ Bonevet” mund të hyjë edhe si pikë e rendit të ditës dhënia në shfrytëzim dhe automatikisht të merret vendimi për shfrytëzimin e hapësirave që “ Bonevet” i ka pasur deri më tani. Nëse shkon përmes ankandit mund të konkurojë edhe dikush tjetër.

Florim Kryeziu-ky vendim që ka ardhur në kuvend për disa pika që është jashtëligjshëm, ansjë nga kuvendarët nuk e ka kërkuar paligjshmërinë, pse po duhet me shfuqizuar këtë vendim, në cilat pika është keq çka ka kërkuar ministria për me shfuqizuar është ëmirë të dimë arsyet pse po shfuqizohet? Për mendimin tem është se rregullorja komunale që është duhet të paguhet për m² dhe kjo nuk është ëbërë me kohë

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kërkesën e z. Haxhiu nuk mund të bëjmë edhe shfuqizim edhe themelim të ri shkojmë me shfuqizim në emër të LVV e përkrahi që në momentin që kthehet nga MAPL për shfuqizim ne do të bëjmë për formimin e komisionit për dhënien e asaj hapësire në shfrytëzim dhe besoj që jemi të gjithë asambleistët që do të përkrahim por duhet të ndjeket rruga ligjore.

Labinot Haxhiu- unë e mendova që të njëjtën pikë me u plotësuar dhe me u filluar procedurat dhe ai vendim e obligon komunën e Kamenicës me i filluar procedurat konfirmimi nga MAPL që e kemi shfuqizuar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- momentalisht nuk mundemi me ndërhyrë në aspektin e emërimit por kur të vijë rrada e shqyrtimit, zototem që do të ndjek rrugën më të shpejt të mundshme.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës, “ Bonevet” është votuar nga ky kuvend por kontratë nuk ka dhe kjo periudhë ka vazhduar për tri vite, mandej ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, i ka dhënë sygjërim komunës së Kamenicës që atë vendim me shfuqizuar se nuk ka pasën bazë ligjore. Ligji dhe udhëzimi i ri për dhënien e pronës nuk mund me dhanë një OJQ në shfrytëzim pa një interes publik. Ne duhet me shfuqizuar me argumentuar në MAPL që kuvendi aktual e ka shfuqizuar vendimin për me gjetën mundësinë ligjore se cili është interesi jonë publik dhe me arsyetuar në vendimin se pse komuna po e jep asetin një organizate jo qeveritare. Ne si puhstet jemi të gatshëm me vazhduar “ Bonevet” , por është herët me thënë mbështetja prej 20 mijë euro, ngase duhet të dimë se sa buxhet duhen. Fillimisht duhet të dinë rekrutimin dhe përgjegjësinë e punëtorëve dhe pastaj si kuvend të subvencionohet kjo OJQ dhe një plan i tillë sot nuk është, në rend dite e ke shfuqizimin e vendimit.

Labinot Haxhiu-ne kemi të drejt edhe nëse atyre të “ Bonevet” ju nevojiten 20 mijë ose më shumë ne kemi të drejt me marrë vendim për përkrahje nga 20 mijë euro për tri vitete e ardhshme.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- jemi të gjithë me përkrah në rast se paraqitet ndonjë plan.

Jeton Biqkaj-kam një kërkesë që është dorëzuar në komunë për ndihmë financiare për Melisa Shabani, ka nevojë për trajtim dhe që ky trajtim është i kushtueshëm këkrojmë që të hyjë në rend dite.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kush është për këtë propozim?

Për u deklaruan të gjithë

Ramadan Basha-proponoj që të hyjë në rend dite ndihma financiare për Edona Leci një vajzë 15 vjeçare që vuan nga një sëmundje, këkresa është dorëzuar në administratë dhe mendoj se ne si kuvend duhet ta mbështesim këtë kërkesë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kush është epër këtë propozim?

Për u deklaruan të gjithë

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi propozimin tjetër fjala është për ish shtëpinë e vjetër kjo pronë në bazë të legjislacionit duhet të jepet me ankand publik dhe nga ministria jemi njoftuar që pronat që jepen me ankand publik të formohen komisione, prandaj e propozoj formimin e komisionit vlerësues për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë 2 nga legjislativi dhe 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile dhe i njëjti komision është i obliguar që t'i fillojë procedurat e ankandit publik pas miratimit nga kuvendit.

Magbule Kastrati-kush është në këtë komision?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nga ekzekutivi janë: Edon Dërmaku dhe Qëndresa Kastrati, ndërsa nga legjislativi duhet të vendosni ju.

Florim Kryeziu-dhënien e pronës në shfrytëzim nuk është mirë me hedhë drejt për së drejti pa kaluar në KPF dhe emërtimin duhet me ja dhënë në bazë të kadastrit që është në certifikatë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-me ligjin e ri secila parcelë që jepet duhet të formohet komision i ri.

Florim Kryeziu- ndryshimi që është bërë legjislacion, rregullore pse nuk e sjellni atë rregullore dhe me u treguar delegatëve se ky është ndryshimi

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- hedhim në votim që të jetë pjesë e rendit të ditës dhe të jetë si pikë e 5 e rendit të ditës, propozim-vendimi për formimin e komisionit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim ish shtëpia e vjetër e komunës, kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për.....18

Kundër0

Abshtenim.....7

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- vazhdojmë me miratimin e tërësishëm të rendit të ditës, kush është për këtë rend dite me këto ndryshime?

Për.....24

Kundër0

Abshtenim.....3

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit Komunal

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni diskutime rreth procesverbalit, nëse jo kush është për miratimin e procesverbalit?

Për.....25

Kundër0

Abshtenim.....2

2. Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit

Ramadan Basha- është një shqetësim mungesa e kryetarit për shkak se mundësia e vetme për ne që me hapën tema dhe me pyet për projekte të ndryshme për zhvillime në komunë, nuk është e mirë për mua mungesa e kryetarit në mbledhjet e kuvendit komunal. Qështja tjetër që dua të gris është ajo e shfrytëzimit të hapësirave publike, në shehs ka filluar vendosja e disa kioskeve dhe jam i informuar që nuk kanë leje për shfrytëzimin e hapësirave, po ashtu kemi shfrytëzim të hapësirave,

po ashtu kemi shfrytëzim të hapësirave, po ashtu kemi shfrytëzim të hapësirave edhe prej disa objekteve të tjera afariste absolut nuk kanë asnjë lloj leje nga organet komunale. Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të kemi një raport nga drejtori për shfrytëzimin e hapësirave publike. Qështja tjetër që po e ngris ka të bëjë me arsim, ka qenë një praktikë e mirë që ne me pasën informacion për zhvillimet në arsim sidomos kur përfundon një gjysmëvjetor ose edhe kru fillon viti i ri shkollor. Është e habitshme për mua që filloj viti shkollor dhe drejtori në atë kohë as që ishte në komunë dhe komuna jonë sikur edhe tjerat u ballafaqua me një mori problemesh duke filluar nga tekstet shkollore që u ndërrua forma e furnizimit dhe ne nuk patëm asnjë lloj informacioni, po ashtu përfundoj gjysmëvjetori i parë, filloj i dyti dhe nuk kemi asnjë informacion për zhvillimet në arsim për problemet që i kemi dhe në ato që po ndëgjojmë se në disa shkolla kanë mungesë edhe të personalit arsimor dhe kjo normalisht ndikon në kualitetin e mësimnxënies dhe normalisht që edhe teksti PIS-ës nuk na rangon mirë. Këtë praktikë është dashur me vazhduar drejtorja e arsimit por sidomos në këto dy intervale neve me na sjell informacion të shkurtë për gjendjen, pregaditjet, sfidat problemet, në këtë formë me radhë.

Magbule Kastrati- a do të jetë kryetari sot në seancë apo jo?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-kryetari është në ministrinë e infrastrukturës me nënshkruar një marrëveshje dhe nuk do të jetë prezent në seancë.

Magbule Kastrati- është dashur koordinim mes juve dhe kryetarit që kur të mbahet ai takim dhe të jetë prezent, ngase është e rëndësishme që ai të jetë prezent, por po shihet se vullneti i tij për komunë është zero, unë personalisht nuk marrë pjesë se nuk kam kujt ti drejtohem për hallet e qytetarëve.

Egzona Isufi-tek raporti i rkyrtarit thuhet: është rregulluar tortuari në lagjen " Iliria" dhe nuk është e caktuar shuma.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës, sipas Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, kryetarin e zëvendëson nënkryetari, por edhe në kohën kur ekzekutivi nuk i ka pyetje direkte mundet me ju përgjigjur me shkrim. Mos prezenca e kryetarit nuk do të thotë se nuk është i interesuar për komunë, por në fakt ai është tani në takim në Ministri të Infrastrukturës dhe ajnë marrëveshjet për vitin 2024 dhe që janë duke u negociuar.

Donjeta Ismajli-më duket pa arsyeshme me liruallë dhe me thënë se nuk kemi kujt të ju drejtohem, pasi prezent e kemi nënkryetarin e komunës.

Egzona Isufi- realisht ne jemi mësuar pak me parë nënkryetarin prezent, po ashtu keni thënë se do të dërgohen në email por deri më tani asnjë përgjigje nuk e kemi marrë.

Rabit Dërmaku-nënkryetari ta: në mandatin e kaluar kuvendi komunal ka votuar për " Bonevet" dhe nuk ka bazë ligjore sipas MAPL-së, pyetja për ju a keni qenë nënkryetar në legjislaturën e kaluar dhe pse nuk ka bazë ligjore.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës-po e vërtet është që isha nënkryetar dhe kuvendi e ka votuar që një hapësirë të vetën t'i japë OJQ " Bonevet", dhe e ka obliguar kryetarin e komunës me lidh kontratë dhe kjo kontratë nuk është bërë dhe kjo oj qe dy vite ka vazhduar të punojë dhe komuna asnjë muaj të vetëm nuk ja ka ndalë shumën buxhetore të ndarë nga kuvendi komunal deri në plotësim ndryshimin e amandamentimit të ri për dhënien e pronës dhe asteve komunale e që kjo bie në kundërshtim me vendimin e kuvendit komunal. Pse nuk është bërë kontrata as unë nuk kam përgjigje, se është dashur direkt të pyetet ish-kryetarin.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-sa i përket vendimit të nxjerr në vitin 2020 është në kundërshtim me dispozitat ligjore sa i përket këtyre dispozitivave. Mundësia e negociimit dhe ofertave nga kryetari në rast kur një investitor ka shprehur interesim për hapjen e një biznesi në interes të përgjithshëm, ndërsa fondacioni "Bonevet" nuk ka qenë biznes por ka qenë OJQ. Neni 7 i ligjit komuna duhet të japë pronën në shfrytëzim të paluajtshme të komunës me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm, po ashtu pse ka qenë i jashtë ligjshëm është se nuk i ka ndjekur procedurat e ankandit publik pra thuhet se ëopr të shfrytëzuar këtë mundësi komuna duhet të zgjedh procedurat sipas nenit 8 të ligjit L 092 të ankandit publik. Tri shkelje janë evidentuar 1nga MAPL-ja dhe të njëjtat në seancën e shkurtit duhet me i harmonizuar dhe me nxjerr një vendim.

Rabit Dërmaku-nga 2020 e deri më tani një O-Q që e shfrytëzon pronën e komunës dhe nuk ka kontratë për atë arsye ja bërë pyetjen nënkryetarit.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës- vendimi është fshehur dhe deri kur është ndryshuar pushteti mandje është parë se qka ka ndodhur të kaluarën.

Jeton Biqkaj- konvikti i nxënësve në Kamenicë është mbyllur, kam ndëgjuar se ka nxënës që kanë kërkuar me u vendos në konvikt a ka ndonjë nxënës që ka konkuruar ngase në kuvend çdo vit është marrë vendim me i hjek shpenzimet e kuvendit e që participimin e kanë pasur falas dhe ne nuk kemi informatë në kuvend nëse është mbyllur konvikti. Pyetjet që i kemi bërë janë dërguar përmes emailit, pro që përgjigje nuk kemi marrë, është dashur që përgjigje të kthehen.

Sejdi Kurteshi-pajisjet e ndriçimit të shehst a i ka amrrë kompania apo janë asete të komunës.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës-asetet që janë kanë në shfrytëzim komuna i ka paguar vetëm për një periudhë të caktuar ato janë asete të paguara për një periudhë të caktuar por që ato i ka marrë mbrapa kompania.

Labinot Haxhiu-pse nuk po i kthejnë përgjegjjet për të cilat e kanë obligim ka shumë pyetje për të cialt nuk kemi marrë përgjegje. Logjika e pikës rendit të ditës pyetje nga legjislativi drejtuar ekzekutivit është për mi bërë të mira për komunitetin dhe vendin. Atë që e tha nënkryetari se është mshefja e vendimin mendoj se është e pasinqertë pasi që MAPL-ja e ka kthyer 3 muaj me vonesë edhe nëse është mshefë ose gjuajtur MAPL-ja nuk e ka respektuar afatin ligjorë për kthim të përgjigjes, kështu që pas 15 ditësh heshtja është aprovim. Sa i përket koleges Magbule e cila e lëshoj seancës, ajo ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm me pyetjet e saj.

Donjeta Ismajli-me cilën njësi matëse je duke e bërë kontributin e kolegës Magbule?

Jadranka Nikolić-për çfarë arsye nënkryetarja serbe nuk prezenton në mbledhje, pasi që kamë kërkuar shumë herë përgjigje nuk kam marrë, prandaj dua të marrë një përgjigje nga ju në lidhje me këtë.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës -ekzekutivin në një komunë e përfaqëson kryetari i komunës, në Kamenicë edhe pse nuk jemi të obliguar ligjërisht me pas një nënkryetar të komunitetit për lehtësimin e komunikimit nëpërmjet komunitetit. Sipas ligjit të vetëqeverisjes lokale është kryetari që e përfaqëson në mungesë të tij i bëhet thirrja sikur në këtë rast unë që jam prezent. Përtej interesit dhe kërkesës tënde që ju keni nevojë me parë nënkryetaren përgjigjet nuk të mungojnë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nënkryetarja e komunitetit serb gjendet në pushim.

Jadranka Nikolić-nuk është dëshira e ime që ta shoh nënkryetaren , ngase kjo është një rregull e shkruar në mandatin e kaluar Bojan Stamenkovic ishte nënkryetar dhe ka qenë prezent në çdo senacë të kuvendit për dallim nga ai ajo në asnjë senacë nuk ka prezentuar larg saj që ajo ka luftuar për të drejtat e komunitetit sepse e njëjta nuk i njeh qytetarët e Kamenicës mos të flasim për fshatrat përreth edhe që në mënyrë jashtëligjshëm është emëruar në atë pozicion dhe ku është ai fat që të respektoni ndonjë ligj në këtë qeveri dhe që keni vendosur nënkryetarin e komunës e cila e ka një rol të tillë.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës-emërimin e saj e ka bërë ky kuvend dhe pa i apsur 50% të votave nga komuniteti serb nuk kish pas mundësi të votohej. Në kuvend jeni dy përfaqësues të kuvendit dhe ju e keni votuar, për atë që e the se nuk e keni zbatuar ligjin, sikur mos të zbatohej ligji do të isha në burg e jo para teje këtu.

Arbnore Beqiraj-lagjja „ Surdulli“ në Karaçevë të Poshtme përballet me probleme të rrymës.

Florim Kryeziu- ligjshmërisht me 10% nuk i ka takuar, por vullneti i këtyre delegatëve e kemi votuar dhe kemi kërkuar në seancë keni thënë se nuk është dhe është sjell një letërnjoftim kopje por do të bëhet nënkryetare dhe do të jetë në krye të vendit asnjëherë nuk kanë ardhë edhe në KPF e ka bërë kërkesën as delegatët nuk e njohin nënkryetaren për komunitete edhe ju edhe nënkryetarja për çdo kuvend duhet të jetë prezent. Ne ja kemi dhënë mundësinë për me i ndihmuar komunitetin në komunën e Kamenicës.

Faton Jakupi-Nënëkryetar i Komunës së Kamenicës-sipas LVL-së ne nuk jemi të barabart me nënkryetarën për komunitete ajo është cila përfaqëson interesa të kryetarit për komunitetet jo shumicë. Në shumë lokalitete në komunën e Kamenicës kemi telashe me energjinë elektrike dikun mungon tensioni është ulur shumë, diku rrjeti është më i ri. Nuk ka më investim të KEDS-it në një projekt diku tjetër në rast se nuk merret leje nga ZRRE-ja dhe është një procedurë e gjatë byrokratike por që ftmërisht kësaj here e kemi nisur një projekt me KEDS-in në Topanicë të Epërme dhe pjesa e Berivojcës që lidhet me fshatin Ranillug. Jemi në dijeni për këto probleme por neve si komunë na tejkalon kompetencat.

Hasan Krasniqi-unë e shoh se punët në komunën tonë po ecin mirë, ka projekte të shumta dhe nuk i mungon asgjë gjatë kësaj qeverisje. Do të dëshiroja të dije se a ka ndonjë pyetje konkrete kolegia për nënkryetaren apo jo jemi në komiteti për Komunitete dhe mund të vini me prezentuar me bërë pyetje, mendoj se deri më tani është një bashkëpunim i mirë në komunë dhe shihet se do të jetë edhe në të ardhmen.

Rabit Dërmaku-po kërkoj përgjegjësi direkte nga drejtori i urbanizmit ose emergjendrave. Në fshatin Shipashnicë të Ulët ka disa herë që kam kërkuar me u rrënuar muri, trotuari ka mbetur në gjysmë kanë mbetur me bërë projekt të ri. Unë kërkoj nga kompetentët që të dalin në teren dhe të rrënojnë atë mur e mos të ndodh ndonjë e keqe, familjari ka thënë se mund ta rrënoni atë mur, pasi që edhe nxënësit çdo ditë kalojnë në atë pjesë. Kryetari është i njoftuar e ka vizituar atë pjesë.

Arlinda Rrudhani-kam një kërkesë nga drejtoria e arsimit që ta merr me prioritet funksionalizimin e printerëve në shkollat e fshatrave të komunës së Kamenicës printerët i kanë jofunksional komplet gjysmëvjetorin.

Shpresa Shala-po ndërlidhem me fjalimin e kolegut Hasan që punët po ecin mirë, unë nuk pajtohem me këtë por gjitha shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve që i kam paraqitur në këtë kuvend gjatë viti 2022/2023 asnjë shqetësim nuk është marrë parasysh kam marrë përgjigje vetëm me fjalë.

3. Propozim-Vendim për miratim të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për kompaninë „ ISO RUBI“ SH.P.K me procedurë të negocimit të ofertës,

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor, kryetari i komunës ka bërë propozim-vendimin për projektin të kompanisë „ ISO RUBI“ i cili ka pruar një kërkesë në komunën tonë i cili është një qytetarë i komunës tonë i cili jeotn dhe vepron në Zvicër ka pasur vullnetin me ardh dhe me investuar në komunën tonë. Investime të tilla janë të mirëserdhura dhe ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik ku edhe siç është cekur në ofertë së paku do të ketë 10 punëtor i cili do t'i angazhojë në kompaninë e tij.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- bëhet fjalë për kompaninë “ ISO RUBI” me pronar Samir Vllasi i cili ka kërkuar një pronë në shfrytëzim për 25 vite. Parcela që është në fshatin Hajnovc pronë shoqërore e komunës së Kamenicës që ka një sipërfaqe prej 9 790 m². Qëllimi i shfrytëzimit të kësaj hapësire është për prodhimin e mbështjellësve të aluminit për sistemet ventiluese, keni një qira që do të ja bëjë komunë së Kamenicës dhe keni kontratën negociuese mes kryetari dhe pronarit në fjalë.

Florim Kryeziu- pse është negociuar për 25 vite, prej kur fillon me u marrë qiraja, në atë parcelë është një objekt dhe aty investon, por nëse pas një viti e lenë investitori punën a keni në kontratë marrëveshjen me bërë shpagimin qka ka investuar a është në kontratë. Prej kur i ka 10 punëtor me i marrë dhe kush është menaxher i kontratës?

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-Kompania “ ISO RUBI” duhet të përfundojë investimet sipas planit të biznesit në afat prej 1 viti, 1 vit ka afat për me implementuar këtë në rast se nuk i përmbush këto kritere edhe komuna e ka të drejtën menjëherë me shkëput këtë kontratë. Sa i përket renovimit kompania ka marrë përsipër me rinovuar vet pa asnjë mbështetje të komunës për me rinovuar objektin.

Labinot Haxhiu-ne jemi të kënaqur që një bashkëvendas i komunës tonë që jeton në Zvicërr e kthehet me investuar në Kosovë. Është mirë mos me kushtëzuar me i marrë 10 punëtorë.
Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-"ISO RUBI" SH.P.K do të angazhohet që numri i punëtorëve të mos jetë nën 10.

Labinot Skovërqani- unë mendoj që duhet me i inkurajuar sa më shumë qoftë investitor të jashtëm apo vendor dhe është ëmirë si drejtorja si zyra e kryetarit me punuar dhe me ju krijuar kushte sa më të lehta që ata me pasën sa më të lehtë që me investuar këtu sepse na duhen. Për 25 vitet e ardhshme nëse kompania funksionon si duhet do të jenë 10 familje duke jetuar në Kamenicë dhe do të jetë diçka shumë e mirë për komunën investime të tjera qoftë të kësaj natyre qoftë natërave tjera.
Jeton Biqkaj-për mendimin tem është në rregull që është bërë negociimi nga kryetari sepse është autoriteti kryesor i komunës i cili i negocion marrëveshjet e tilla. Qështjen që e kam ngritur edhe në KPF është se ne si komunë duhet t'i shohim të gjitha rrugët sa më shpejt dhe sa më mirë që mos të ketë pengesa në sektorin në të ardhmen. Ne kemi pasur shumë raste që kanë dhënë prona ose kanë filluar me ndërtuar qoftë edhe fabrika dhe kanë hasur në probleme në komunë pikërisht për leje për qështje të funksionalizimit për shkak të PZHK-së.

Sejdi Kurteshi- ata që vijnë me investuar mirë se ardhshin dhe është ëmirë ne si kuvend mos me krijuar procedura byrokratike dhe mos me penguar ato punë . Në parcelë janë 1 ha/tokë gjë që i jepen në shfrytëzim për 25 vite, por është edhe një objekt aty dhe në kontratë nuk po duket ai objekt sa m² i ka dhe sa ka me i rinovuar dhe investitori mund të rrafshojë atë objekt se në kontratë nuk është asnjë objekt.

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-gjitha kërkesat që janë adresuar nga investitorët me potencial drejtorisë tonë, gjitha janë shkuar tek drejtorja e urbanizmit me i parë dhe me i harmonizuar me Planin Zhvillimor Komunal.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nëse nuk keni pyetje të tjera vazhdojmë me procedurë të votimit.

Kush është për miratimin e pikës së 3-të?

Për.....20

Kundër0

Abshtenim.....0

4. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (lokali ish "Shtëpia e Vjetër e Komunës")

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-kjo është e rinovuar dhe shëndrruar në park teknologjik me ndihmën e ministrisë së zhvillimit rajonal i cili objekt i cili do të jetë në dispozicion të të rinjëve për të ndjekur trajnime të ndryshme në fusha programimi gjuhë programuese të ndryshme pa pagesë si dhe zyrat që janë brenda këtij objekti mendohen të shfrytëzohen për biznese "Start UP" të ndryshme që vinë idetë dhe veprimtaritë e ndryshme që të rinjtë mund t'i zhvillojnë të ardhme. Për ta funksionalizuar këtë projekt do të ketë qëndrueshmëri mendojmë të japim në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër që nënkupton periudhën tre vjeçare ka shumë të interesuar për marrjen në shfrytëzim të këtij objekti si UBT-ja, Kaktus-i, dhe duhet të kalojë përmes procedurave të ankandit të cilat procedura duhet t'i udhëheq komisioni përkatës i cili duhet të formohet bashkarisht me ju.

Jeton Biqkaj-a është fjala për objektin e komunës ku ka funksionuar administrata në të kaluarën apo për cilën është fjala?Ato që e thatë për biznese "Start UP" kjo mendoj se nuk përputhet me atë që e hedh në ankand, nuk kemi ndonjë specifik se çka në cilat fusha, qoftë në teknologji, park teknologjik, duhet të ketë specifikim s'epër çka ne mund të japim atë objekt.

Faton Jakupi-Nënëkryetar i Komunës së Kamenicës-Kryetari i komunës bashkarisht me fondacionet e ka rinovuar ish objektin "Filmi i Vjetër", dikur ka qenë qendra rinore, ai objekt është rinovuar për park teknologjik. Thirrjet e organizatave, OJQ-të, Bizneset, kanë të bëjnë me park teknologjik, gjitha që kanë të bëjnë me aftësimin e nxënësve dhe të rinisë në Kamenicë IT-ve dhe gjithqka tjetër. Fjala

është për këtë objektin që është rinovuar afër komunës së tanishme për të cilën duhet të merret leja nga ju për me pasën mundësinë me shpall në ankand, hapësirat e ndara veç e veç për organizatat ose bizneset që kanë të bëjnë për zhvillimin e fushës së teknologjisë e që me thirr në objekt si tanësi përtej bizneseve të ndryshme të mundshme që kanë me qenë aty në hapësirën që ofron park teknologjik për komunën tonë.

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-objekti është i rinovuar për atë qëllim park teknologjik jo për ndonjë veprimtari tjetër dhe komisioni që formohet këtu ata i udhëheqin procedurat.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nëse nuk ka diskutime të tjera, vazhdojmë me procedurë të votimit. Kush është për miratimin e pikës së 4-të ?

Për.....20

Kundër0

Absntenim.....0

5. Propozim-Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të ish " Shtëpia e Vjetër e Komunës"

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,ky komision vlerësues përbëhet nga pesë anëtarë 2 anëtarë vien nga legjislativi, 2 anëtarë nga ekzekutivit dhe 1 nga shoqëria civile, ky komision ka për detyrë që t'i udhëheqë të gjitha procedurat e ankandit publik në mënyrë që kjo parcelë ta bëjë zgjidhjen e saj.

Jeton Biqkaj-më duket se propozim-vendimi nuk është në rregull se kemi të bëjmë me një komision që e formon kuvendi dhe këtu nuk është shumica e kuvendit, mendoj se 3 duhet të jenë nga kuvendi, një nga ekezutivi dhe një nga shoqëria civile, në aspetin juridik mendoj që nuk është në rregull.

Faton Jakupi-Nënëkryetar i Komunës së Kamenicës-në fakt jeni shumicë janë dy anëtarë të juaj dhe të OJQ-së e propozoni ju.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,sa i përket komisionit vlerësues 2 anëtarë janë nga kuvendi, vazhdojmë me propozimet. Duke u bazuar në nenin 17-të për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës e parasheh që ky komision të jetë 5 anëtarë, prej tyre 2 legjislativi, 2 ekzekutivi dhe 1 OJQ, vazhdojmë me propozime:

- **Labinot Haxhiu** propozon **Fitim Gagic** -PSD
- **Jeton Biqkaj** propozon **Sejdi Kurteshi**- LDK
- **Lirim Kryeziu** propozon **Arbnore Beqiraj** –LVV
- **Florim Kryeziu** propozon **Rabit Dërmaku** PDK

Sejdi Kurteshi- deklarohet se tërhiqet nga komisioni.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, kemi 4 propozime për dy vende dhe këta dy që marrin më së shumti vota do të jetë pjesë e komisionit dhe një asambleist do të votojë për dy kandidat që janë të propozuar.

Kush është për Fitim Gagicën?

Për.....8

Kush është për Rabit Dërmaku?

Për.....16

Kush është përArbnore Beqiraj?

Për.....13

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- në bazë të rezultatit kandidati **Rabit Dërmaku** ka **16 vota** dhe **Arbnore Beqiraj** **13 vota** dhe pjesë e këtij komisioni janë: **Rabit Dërmaku**, **Arbnore Beqiraj**, **Edon Dërmaku**, **Qëndresa Kastrati** dhe **Sherafedin Vranja**. Vazhdojmë me votimin në tërësi të këtij komisioni, kush është për formimin e këtij komisioni ?

Për.....16

Kundër0

Absntenim.....1 miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

6. Propozim-Vendim për shfuqizimin të vendimit nr.6569 i datës:04.03.2020

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni diskutime për këtë pikë nëse jo e hedhim në votim, kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....22

Kundër0

Absntenim.....0

7. Raporti i Kryetarit të Komunës për 6-të mujorin e dytë të punës për vitin 2023

Faton Jakupi-Nënëkryetar i Komunës së Kamenicës-komuna është një ndër 5 vendet e para për transparencë komunale në nivel të Kosovës. Është përfunduar shkolla e re profesionale në Kamenicë, bashkëpunim me organizatën “ Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 10 shtëpive, 3 prej tyre janë liruara dhe familjarët janë duke banuar. Nga MAPL-ja e kemi hartuar planin e integritetit dhe kemi marrë dekorata, QKMF-ja Kamenicë është pajisur me ultraza 4D. Vlera e investimit në rrugë e njohur “ xhadja e vjetër” e fshatrave Berivojcë, Koretin, Topnaicë, “ Orana” e Busavatës dhe fshatrave Firiqevë, Gjyrishec, Malësia e Kamenicës, kemi një kontratë prej 2.6 milion euro,. Po ashtu 1.7 milion euro në shkollën fillore “ Fan S Noli”,që është bërë kontrata kur kanë filluar punimet por nuk janë realizuar 1.7 milion. Komuna e Kamenicës me rregulloren e re që përmabn lehtësime për kategoritë e bizneseve fillestare 200 mijë euro janë ndarë në grande për biznese, stadiumi në Hogosht është prej 1.6 milion euro, xhamia në Meshinë përmes ministrisë për renovimin e tyre, riorganizimin e shtëpisë ku ka nejt “ Mulla Idriz Gjilani” në Gjyrishec, shuma është 152 mijë euro, shkolla “ Metush Krasniqi” në Roganë, në vlerë prej 850 mijë euro nga fondi i BE-së,180 mijë euro është bërë me projektin që e kemi pasur me fondin e efijencës së energjisë paralel me shkollën e gjimnazit dhe qendrën për punë sociale. 250 mijë euro vlera e investimit në parkun e aventurave projekt që e përbënë fazën e dytë të “ Lugut të Verdhë”, po ashtu dizajnimi i pritoreve të autobusëve në Kamenicë është bërë nga nxënësit e komunës së Kamenicës dhe sa për informacion për znj. Jadranka për nënkryetaren e cila dje ka diskutuar për një marrëveshje që jemi duke e diskutuar prej një organizatës që të bëhen dy pritore “smart” dhe drejtorja e shërbimeve publike do të bëjë vetëm kyçjen e saj për energji elektrike. Komuna e Kamenicës është e para në Kosovë për transparencë përafërsisht 730 mijë euro është vlera e investimeve për dizajnimin urban të qytetit në kuadër të projektit nga MASHT-i, Komuna e Kamenicës tani më ka qendrën e karrierës, Ambasada Amerikane ka investuar në vlerë prej 150 mijë dollarë në shkollën në Hogosht, rreth 440 mijë euro është vlera e investimit e shtrimit të 27 rrugëve lokale në Kamenicë.Ka filluar puna në renovimin ndërtesave banesore sociale në komunën e Kamenicës investimi në vlerë prej 138 mijë euro në trotualet e komunës së Kamenicës, janë siguruar barnat falas për pensionistët e Komunës së Kamenicës, janë pajisur të gjitha institucionet publike me aparat për shuarjen e zjarrit në komunën e Kamenicës. Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Kamenicë tani ofron edhe shërbime gjinekologjike, po rregullohet sistemi i ujësjellësit në fshat 350 mijë euro në Karaçevë të Epërme,100 mijë euro për rritjen e ujësjellësit në Hodonovc dhe Dajkovc, investim prej 179 mijë euro në rrugën Malush Selishtja dhe Karaçeva e Epërme, 75 parkingje të gjelbërta dhe këndi i lojërave tek amfiteatri i qytetit, rregullim i trotuarit në lagjen “ Iliria” 38 biznese përfituese të grantit komunal ku 11 prej tyre janë

biznese të reja "Start Up", kurse 27 ekzistues. 72 mij 400 euro vlera e investimit në rrugën "Bugaqku", energji e pastër tek gjimnazi ku do të rinovohet kulmi gjimnazit. Furnizimi me 160 llaptop, asfaltimi në Leshtar, renovimi i AMF-ve në Topanicë, tani do të filloj edhe renovimi i AMF-së në Busavatë. Sa i përket dëgjimeve buxhetore jemi ndër komuna prijëse me numrin e madh të dëgjimeve janë ndarë buxhet prej 800 mijë euro për rrugët "Orana" në Busavatë dhe "Isuf Morina" në Topanicë rruga e vjetër Berivojcë- Koretin, Qerdhja "Filizat" është rinovuar, ndërtimi i kolektorit në Shipashnicë të Epërme është miratuar buxheti e që falënderoj juve për gatishmërinë dhe votimin. Kontratë prej 331 mijë euro për rregullimin e sistemit të ujërave të zeza në fshatrat Karaçevë dhe Koretin, vazhdon pajisja e nxënësve me rekuizita sportive, rregullimi dhe zgjerimi i rrugës kryesore në Berivojcë, përkrahja e fermerëve dhe subvencionimi i tyre me farë gruri dhe pleh artificial, praktika e të rinjve me UNDP-në për nxënësit që po mbajnë praktikë. Do të nënshkruajnë kontratë për suportimin e nxënësve në gara rajonale dhe të profesorëve që i aftësojnë ata nxënës, shkollat në Kamnicë me sistem digjital të vijueshmërisë, QKMF-ja në Kamenicë pajiset me autoambulancë, për vizita në shtëpi në procesin e vaksinimit, njëkohësisht falënderojmë shoqatat që e kanë bërë të mundshme furnizimin e një autoambulanca edhe për QMF-në në Roganë. Kontrata e fundit që është për është për asfaltimin e rrugës 1.5 milion euro në Feriqevë –Gjyrishec, dhe rruga "Bejtë Pireva".

Jadranka Nikolic-nuk ju kuptova se në qfar kontakti e përmendët nënkryetaren për komunitete, pasi që nuk kam asnjë lloj bashkëpunimi me të, do të doja të dija se për qfar arsye e keni përmendur emrin tem me të nënkryetares sigurisht ka të bëjë me ndonjë projekt dhe që unë nuk jam e njoftuar?

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës-komuna e Kmanicës është duke i ndërtuar pritoret e stacioneve të autobusëve në mesin e tyre kemi arritur një marrëveshje me një organizatë dy prej tyre me qenë "Smart" dhe drejtorja e jonë me marrë përgjegjësi për furnizim me energji elektrike, ku aty do të kenë edhe rrjetin e EËFis dhe furnizim për bateri të telefonave.

Jadranka Nikolic-nënkryetarja nuk bashkëpunon me komunitetin unë nuk kam lidhje me asnjë lloj të projektit dhe është ëmirë që së paku një herë në vit të jetë prezent në kuvend, ajo i ka shrytëzuar të gjitha pushime mjekësore.

Labiot Hahxiu-si formë e përgaditjes së raportit më duket si e dobët se diku fillon me fajlë, diku me numra, diku me rreshta dhe decidivisht duket keq. Diçka tjetër është që po përsëriten të njëjtat projekte, diku mund të jetë gabim teknik shembull ujërat e zeza shembull në Koretin. Diçka që më la përshtypje është subvencionimi i nxënësve të dalluar 4140 euro dhe mësimdhënësve 6300 euro më duke e palogjikshme pasi që më hsumë kemi nxënës se mësimdhënës edhe pse nuk po dua me ja humb asnjë merit atyre mësimdhënësve. Kisha dasht edhe listën e projekteve në vlerë prej 15 milion euro investime për Kamenicën kërkesë zyrtare me na sjell në seancën e ardhshme.

Ardita Dërmaku- Drejtorja për Buxhet dhe Financa-këto projekte janë të financuara prej ministrisë prej qeverisë së Kosovës, të gjitha mund t'i gjeni në ligjin e buxhetit por ne për muajin e ardhshëm do të përgadisim për secilin projekt veç e veç dhe për shumën, por e keni edhe në ligj të buxhetit që secili prej jush mundet me pa.

Jeton Biqkaj-unë sa e di 15 milion ka të bëjë me buxhetin e tërësishëm të komunës së Kamenicës dhe nuk janë 15 milion investime në vitin 2024 është ëmirë të i bëni këto dallime për me qenë 15 milion së paku duhet me i pasur 15 projekte nga 1 milion euro ?

Kemi të bëjmë me 15 milion investime nga qeveria në vitin 2024 në komunën e Kamenicës dhe unë po them që buxheti total i komunës së Kamenicës për vitin 2024-të është 15 milion, duke përfshirë: pagat, grandin e arsimit, pagat subvencionet dhe investimet 2 milion 100 mijë për investime kapitale.

Faton Jakupi-Nënkryetar i Komunës së Kamenicës- çdo vit deri në fund të marsit votohet buxheti i vitit, por kur të bëhet është ënë planifikim buxhetor në KAB deri në 3 vjet në ligjin e buxhetit për vitin 2024, komuna e Kmanicës i ka të planifikuara më shumë se 15 milion euro, por që janë të listuara projekte të reja 15 milion euro. Një prej projekteve është stadioni i atletikës 3 milion euro, tjetra është rruga Sfirçë-Gjyrishec-Lisockë, dhe krejt këto rrugë kanë vlerën më shumë se 2 milion euro. 4-5 rrugë janë të planifikuara të reja. Projekte të reja të planifikuara por që ligji thuhet ligji i buxhetit për vitin 2024.

Labinot Haxhiu-kur e kemi votuar buxhetin në shtator 2023 dhe të 2024 i kemi votuar diku rreth 7 milion euro për investime kapitale me kete logjiken KAB-it, votimi i buxhetit është vetëm për vitin 2024, ato tjerat janë planifikim.

Sejdi Kurteshi-ata që po e paraqitni se në 2024 do të ketë 15 milion euro investime dhe unë ju them se investimi dhe planifikimi dallon. Shembull rruga Tuxhevc, Gjyrishevc duket të jetë për tri vite e parapamë dhe kur e përpjeston për tri vite aty bie diku 5 milion për një vit. Shumica e investimeve janë përfunduar nga qeverisjet e mëhershme dhe tani skanë mbetur shumë punë në qeverinë tuaj. Ju nuk po hapni vende të punës siç keni premtuar, keni thënë se çdo familje do të ketë nga një të punësuar, kjo nuk është realizuar.

Hasan Krasniqi-po shihet që mandatin e ardhshëm nuk po mbetet me punuar asgjë.

8. Informatë për Raportin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe planin e veprimit të Komunës së Kamenicës për vitin 2023

Ismet Ahmeti-Drejtor, Njësia e Auditimit të Brendshëm, njësia e auditimit në fillim të vitit përgatit raport andaj kryetari i komunës ka nxjerrë një informatë të shkurtë mbi punënn e njesisë së auditimit të Brendshëm, ngase raporti bazë i ka 19 faqe. Kryetari ka nxjerr disa informata më relevante sepse njësia e auditimit të brendshëm sipas ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike neni 21 paragrafi 1 i raporton vetëm Kryetarit të Komunës dhe e njofton komitetin e auditimit.

Labinot Haxhiu-tek pika e 4-të ku janë 20 rekomandime dhe gjatë përcjelljes 7 janë zbatuar në tërësi, 11 rekomandime janë në proces dhe dy nuk janë zbatuar.

Ismet Ahmeti-Drejtor, Njësia e Auditimit të Brendshëm-kryetari në këtë raport nuk i ka parqit, por unë po të përgjigjem nga raporti i përgjithshëm. Dy rekomandime të cilat nuk janë zbatuar janë në zyrën e prokurimit, zbatimi në procedura të prokurimit për furnizime me mallra, shërbime dhe punë, njëri ka të bëjë me leje ndërtimore. Gjatë verifikimit të pajisjes me leje ndërtimore, para inicimit të procedurave në prokurimit për kryerjen e punës në 8 mostra të marra kemi gjetur që asnjë projekt nuk posedon leje ndërtimore. Për verifikim kemi marrë këto projekte: ndërtimi i puseve të ujit të pijes, asfaltimi i rrugëve në komunën e Kamenicës, ndërtimi i trotuareve në qytetin e Kamenicës dhe fshatrat Topanicë, Kopërnice, Karaçevë, Shipanshnicë dhe Roganë, ndërtimi i terreneve sportive në kuadër të institucioneve arsimore Roganë, Karaçevë, Kamenicë, Petrit, Kamneicë, ndërtimi i sistemit të ujit të pijes në fshatrat: Muçivërcë, Roganë, Novosellë, Hodonovc, Petrit, Dajkovc kycjet individuale. Renovimi i AMF-ve, në Topanicë dhe renovimi i ndërtesës sociale në Kamenicë, shenjëzimi i shtigjeve malore për ecje dhe monumente kulturore, ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatrat Shipashnicë, Karaçevë, Busavatë, Kopërnice, Koretin dhe Topanicë. Tek ky kanë qenë tri rekomandime dhe rekomandimi i parë shkon për funksionimin e sistemit të zbatimit të kontrollit të brendshëm, me i pasën 10 rekomandime, 1 rekomandim mos me u zbatuar del sistemi i kontrollit të brendshëm që ka qenë jo funksional dhe për atë arsye është përfshirë edhe sistemi i kontrollit brendshëm në fazën e pajisjeve së projekteve në leje ndërtimore para fillimit të procedurave të prokurimit dhe caktimit të menaxherëve nuk ka funksionuar.

Florim Kryeziu-më herët ja bëra kryesuesit një pyetje për dhënien e pronave në shfrytëzim a keni menaxher, dhe auditori tha se nuk kemi, ndërsa nënkryetari e ceki se nuk ka kontratë "Bonevet" ju si auditor a bëni rekomandime për këto për vitin 2024-të?

Ismet Ahmeti-Drejtor, Njësia e Auditimit të Brendshëm- në planin e sivjetëm për vitin 2024-të që e ka aprovuar kryetari i komunës dhe komiteti i auditimit tek komiteti i auditimit, bizneset komunale për taksa komunale dhe qira e kemi shti edhe menaxhimin e pronave të dhëna me qira, do t'i marrim kontratat do t'i shikojmë dhe me i shikuar a ka të caktuar menaxher në ato kontrata a kanë sjell ndonjë raport.

9. Informatë për Raportin e Performancës Komunale për vitin 2022

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- siç dihet komuna e Kamenicës ka filluar raportimin në sistemin e performancës komunale prej datës: 7.8.2023-7.09.2023, gjithsej janë 19 fusha ku komuna e Kamenicës ka bërë raportimin e tyre me 111 tregues nga 119 gjithsej të pranishëm, 8 tregues që nuk ka raportuar komuna e Kamenicës, në momentin e raportimit kanë qenë të ngrira nga MAPL-ja, janë disa fusha në të cilat janë rezultatet krahasuese prej vitit 2021-2022 dhe sa i përket komunës kemi një ngritje mjaft të lartë në performancën komunale në MAPL ku edhe organizata te ndryshme komunën e Kamenicës sa i përket transparencës, llogaridhënjes, performancës e kanë ngritur në nivel më të lartë. I keni të gjitha fushat, rezultatet nëse keni pyetje **Labinot Haxhiu**-a i ka mbush kriteret komuna e jonë për grand të performancës?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- komuna e jonë nuk është ëprfituese për shkak se nuk është plotësuar kriteri i auditimit katër kriteret që ishin, tri janë zbatuar dhe një nuk është zbatuar dhe për këtë arsye nuk është përfituese komuna e Kamenicës.

Labinot Haxhiu-nëse keni informatë se cilat kriteret janë është edhe respektimi i vendimeve gjyqësore.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- janë katër kriteret që duhet me i respektuar që kërkohen, mbushja e informatave në SIM, harmonizimi i vendimeve të kuvendit, pozicioni i auditorit dhe shpenzimi i buxhetit 75%, vetëm sa i përket raportit të auditimit ka qenë pengesa.

10. Shyqrtimi i raportit tremujor financiar Tetor-Dhjetor 2023

Ardita Dërmaku- Drejtorja për Buxhet dhe Financa-Raporti i tremujorit të katërt financiar për vitin 2023. Ky raport është përgatitur në bazë të Ligiit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 45.6. sa i përket të hyrave grumbullimi i të hyrave ka vazhduar edhe gjatë këtij tre mujori vlera ka arritur në 18.42⁰/0 të buxhetit të planifikuar për periudhën Tetor-Dhjetor 2023, Të hyrat tatimore kanë shënuar një rënje prej 63.73 ⁰/0 , që korrespondon me 125,001.06 € më pakë krahasuar me tremujorin e vitit paraprak. Të hyrat jo tatimore kanë shënuar një rritje krahasuar me vitit paraprak për periudhën tremujore të fundit prej 4.18% që korrespondon me 4,218.29€. Nga inkasimi i të hyrave në vitin 2023, në vlerë prej 176,204.04 €, do të ju paraqesim tabelat më poshtë. S ai përket performancës së shpenzimeve buxhetore e dini që në shpenzimet buxhetore bëjnë pjesë 5 kategori në paga dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencionet dhe investimet kapitale. Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 2,139,520.43 €. Shpenzimet në mallra dhe shërbime kanë shënuar një rritje prej 17.22⁰/0 krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur 883,006.68€ Tetor-Dhjetor 2022 apo 43.66⁰/0 nga buxheti i terësishum. Shpenzime në komunal, kanë shënuar një ngritje 9.61 % apo në shumë prej 5,971.06 € krahasuar me vitin 2022. Shpenzimet në subvencione dhe transfere, shënuan zvoglim prej 9.67⁰,4 apo në shumë prej 23,765.55 €. Shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 1,250,432.95 €, që është 3.49⁰/0 më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë nga Viti i kaluar .Ekzekutimi 45.82⁰/0 krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Nuk po ju marrë kohë më shumë nëse keni pyetje unë jam këtu.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,- nëse nuk ka pyetje vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

11. Informatë për aktivitetin e KKS-së për vitin 2023

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ky këshill i ka mbajtur 6 mbledhje brenda këtij viti kalendarik ku e ka përmbushur në tërësi planin. Mbledhjet kanë pasur karakter për siguri në komunën e Kamenicës të njëjtat mbledhje janë monitoruar edhe nga MAPL dega e Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjithashtu kjo ministri është pajisur me të gjitha procesverbalet të cilat janë mbajtur gjatë këtyre takimeve dhe anëtarët e këtij komisioni i kanë kryer të gjitha obligimet me përgjegjëshmëri të plotë me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për komunën e Kamenicës. A e dëshiron fjalën dikush, nëse jo kalojmë në pikën tjetër.

12. Shqyrtimi i planit lokal të veprimit për barzainë gjinore 2024-2026

Teuta Kastrati-Zyrtare për Kthim, Riatdhesim dhe Zyrtare për Barazi Gjinore, para vete e kam letrën e kryetarit që do ta lexoj para jush: Kam kënaqësinë që si Kryetar i Komunës së Kamenicës të prezantoj këtë dokument të vyer dhe shumë të rëndësishëm të hartuar me qëllimin e trajtimit të barabartë si dhe munësive të njëjta për të gjithë. Kjo edhe njëherë prezanton angazhimin tonë të sinqertë e të vazhdueshëm për të nxitur një shoqëri më gjithpërfshirëse dhe të barabartë brenda Komunës së Kamenicës. Duke njohur rolin kryesor që luan drejtësia gjinore në formësimin e së ardhmes së vendit tonë kam kënaqësinë të prezantoj këtë plan gjithpërfshirës që synon adresimin e sfidave të shumëanshme me të cilat përballen individët e të gjitha identiteteve gjinore në baza ditore. Zhvillimi i këtij planika qenë përpjekje bashkëpunuese, duke përfshirë zërat e palëve të ndryshme të interesit, drejtuesve të komunitetit, aktivistëve, qytetarëve e institucionit. Nëpërmjet një qasje gjithpërfshirëse dhe pjesëmarrëse ne kemi identifikuar fushat kryesore ku ndërhyrjet e synuara mund të kenë një ndikim thelbësor në promovimin e drejtësisë gjinore brenda komunës sonë. Jam entuziast për ndikimin pozitiv që ky plan do të ketë në strukturën sociale të komunës duke forcuar angazhimin tonë për drejtësi, barazi dhe dinjitet për të gjithë. Për më tepër jo ftoj secilin nga ju që të jeni pjesë aktive në zbatim dhe monitorimin e këtyre nismave. Ne e kuptojmë se arritja e drejtësisë gjinore është një proces i vazhdueshëm dhe ekspertiza e bashkëpunimi juaj janë pjesë përbërëse e suksesit të tij. Jam i bindur se së bashku ne mund të krijojmë një qytet që gëzon diversitetin, vlerëson barazinë dhe nxit një mjedis ku të gjithë mund të përfaqësohen. Sinqerisht: Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës.

Ky plan është hartuar për herën e parë në komunën e Kamenicës i cili është gjithpërfshirës dhe është plan tre vjeçarë për komunën e Kamenicës. Me urdhër të kryetarit dhe vendimit të datës: 30.10.2023 është themeluar një grup punues i cili është për hartimin e këtij plani e që është i përbërë nga 13 anëtarë. Shuma e këtij plani 343 mijë 704 euro, për vitin 2024 nuk janë të planifikuara mjetet për arsye se ky plan ka ardhën në zbatim dhe në përpilim qysh pas planifikimit dhe shqyrtimit të buxhetit për vitin 2024. Shumën 217 mijë do të fillojë të realizojë e ka shumën totale për dy vite prej vitit 2025 në vitin 2026 e ajo është 217 mijë 620 euro, ndërsa shuma prej 125 mijë 612 euro është e paraparë që këto mjete nuk ekzistojnë por me anë të lobimit të gjithëve duke përfshirë edhe grupin e grave por edhe drejtoritë tjera mund të themi se do të llobojmë fuqishëm që ti marim këto mjete dhe planin që është e paraparë këto tri vite munësisht ta realizojmë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a e dëshiron dikush fjalën nëse jo vazhdojmë me procedurë të votimit.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....20

Kundër0

Abshtenim.....0

13. Propozim-Vendim për furnizimin të fermerëve me mekanizëm bujqësor

Shpend Morina – Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kjo pikë ka të bëjë me krijimin e kodit të participimit tek projekte në fushën e bujqësisë, projektet që kanë participim të fermerëve, konsiderohet si e hyrë e jashtme dhe prandaj si procedurë që dy vite së pari duhet të marrë miratimin e kuvendarëve shumicës së thjeshtë dhe pas kësaj nëse e merr miratimin shkon në ministri të financave ku edhe atje duhet ta marrë një aprovim, pas përfundimit të krejt këtyre procedurave nga buxheti i kdrejtorisë mund të bëhet pagesa për aprovim.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni pyetje rreth kësja pike, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....21

Kundër0

Absntenim.....0

14. Kërkesë për ndihmë financiare për Melisa Shabanin

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-kemi dy raste për ndihmë financiare do të votojmë për dy rastet me nga 3 mijë euro.

Kush është që t'i ndahet shuma prej 3 mijë euro Melisa Shabanit?

Për.....të gjithë

15. Kërkesë për ndihmë financiare për Edona Leci

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi kërkesën për Edona Lecin e njëjta kërkon trajtim jashtë vendit dhe kërkojmë që bashëkrisht të votojmë në mundësi financiare prej 3 mijë euro.

Kush është që t'i ndahet shuma prej 3 mijë euro Edona Lecit?

Për.....të gjithë

16. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 12:40

Procesmbajtës


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës



Liridon Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 3052
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 26/01
Br. str. Datum: 2024
KAMENICËJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në bazë të neni 12 dhe 40 përparagrafi 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës dhe neni 12 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më _____ 2024 miraton këtë:

Sh.02.Nr.14 dt. 25.01.2024

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.7976

1. NDRYSHOHET dhe PLOTËSOHET pika (1) një, nën paragrafi (1.7) një pikë shtatë, (1.8) një pikë tetë dhe (1.12) një pikë dymbëdhjetë i Vendimit bazë Sh.01.nr.7976 i dates 09.03.2023 për formimin e komisionit për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2024-2026, me përbërjen si në vijim:
 - 1.1. Në paragrafin (1.7) një pikë shtatë në vend të anëtares së Komisionit znj.Valdete Berisha (ZK), caktohet anëtare e re e Komisionit znj.Lidiona Maroca.
 - 1.2. Në paragrafin (1.8) një pikë tetë në vend të anëtares së Komisionit znj.Florentina Kryeziu (DMSH), caktohet anëtar i ri i Komisionit z.Edon Dërmaku.
 - 1.3. Në paragrafin (1.12) një pikë dymbëdhjetë në vend të anëtarit të Komisionit z.Bajrush Kriezi (ZLK), caktohet anëtare e re e Komisionit znj.Aleksandra Jovanovic (nënkryetare e Komunës për Komunitete).
2. Detyrat e anëtarëve të Komisionit si në pikën (1) një, paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij vendimi, janë të përshkruara në Vendimin bazë Sh.01.Nr.7976 i dates 09.03.2023 për Organizimin dhe Mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2024 – 2026.
3. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Kuvendit, Zyrës për Informim dhe arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi i Komunës

Bazuar në nenin 12, 14 dhe 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, neni 13 paragrafi 1, dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 dhe neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më **,**.2024 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale Përmes Ankandit Publik - Lokal "Objekt Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati"''

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës me numër kadastral P-71107041-01981-0, përkatësisht pjesët të objektit me numër të parcelës kadastrale O-71107041-01553-0-35-0 kati P- pjesë nga hapësira mbrenda Ndërtesës – Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati" Kamenicë, me sipërfaqe prej 400m², si dhe bodrumi nga e njëjta ndërtesë me sipërfaqe 66m², e cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K Kamenicë.
2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.
3. Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, realizohet përmes ankandit publik.
4. Shfrytëzimi pronës së Paluajtshme Komunale pjesë e objektit të Shtëpisë së Kulturës "Isa Kastrati" do të jetë në kohëzgjatje si në pikën (3) tre të këtij vendimi dhe është pa kompenzim.
5. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe Përfituesi i marrjes në

shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudh afatshkurtër të shfrytëzimit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkiv.

Kryetari i Komunës



Kadri Rahimaj





KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICE
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenice



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4708



Koha/ Vreme/ Time: 02:00:50



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : O-71107041-01553-0-35-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	230/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	12.02.2024 - 13:57
Komuna / Opština / Municipality:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kamenicë / Kamenica / Kamenice
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
O-71107041-01553-0-35-0	NDËRTESË / ZGRADA / BUILDING	Shogore / Društvena / Socially	U	2459.49	VENDIM - Kuqendri Komunal i Kamenicës, Nr.9235, e dat.29.03.2019.	13.12.2019	18.12.2019

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LUMI / KAMENICA / REKA		B-P+1		18.12.2019



A.3 NDËRTESTESAT / ZGRADE / BUILDINGS

Numri i ndërtëse Broj zgrade Building Number	Lloji i ndërtësës Vrsta zgrade Building Type	Shtyrëzimi aktual i ndërtësës Trenutno korišćenje zgrade Building Current Use	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Katet Spratovi Floors	Leja e ndërtimit Gрадјевинска дозвола Building permit	Viti i ndërtimit Godina izgradnje Construction Year	Numri i parcelos Broj parcele Parcel Number	Azhurnuar Ažurirano Updated
O-71107041-01553-0-35-0	Kultura/Kultura/Culture	Ndërtësat tjerë kulturorë/Osiale kulturne zgrade/other culture building	2459.49	B+P+1	V E N D I M - Kuveni Komunal i Kamenicës, Nr.9235, e dat.29.03.2019.			18.12.2019

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasništvo (1 VL.) / Single Owner	Komuna e Kamenicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1	VENDIM - Kuveni Komunal i Kamenicës, Nr.9235, e dat.29.03.2019.	26.12.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008) neni 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës lidhur me nenin 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, kërkesës Sh.02.nr.3790 e datës 02.02.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me nr. të references 07/1-2/SPMK-M/007/2024, neni 3 paragrafi 3.7 neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2024 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës - SPMK Muçivërc

1. Me këtë Vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës, në bazë të Kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kërkesës Sh.02.nr.3790 e datës 02.02.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me nr. të references 07/1-2/SPMK-M/007/2024 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, pa procedurë të rregullt të Konkurrimit bazuar në ligjet në fuqi.
2. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, Objekti i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Kopernicë, dhe i ka këto karakteristika parcela me numër të ngastrës katastrale P-71107039-00617-2 me sipërfaqe prej 4112 m², përkatësisht objekti i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Kopernicë, P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K. Kamenicë.
3. Qëllimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin (2) të këtij vendimi është shfrytëzimi i objektit Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Kopernicë për nevojat e SPMK Muçivërc, pasi që gjendja e objektit të SPMK Muçivërc është shumë në gjendje të keqe për shkak të vjetërsisë së objektit fakt ky i konstatuar edhe nga ana e Inspektorëve Sanitarë, dhe objekti i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Kopernicë është në gjendje të mirë dhe më i përshtatshëm për Policinë e Republikës së Kosovës SPMK Muçivërc.

4. Afati kohor për dhënje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi jepet në shfrytëzim prej 5 (pesë) vitesh, me mundësi vazhdimi.
5. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim. Me qëllim të rikthimit të objektit Komunal në shfrytëzim për Policinë e Republikës së Kosovës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkivi.

Kryetar i Komunës


Kadri Rahimaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



ARSYETIM

Te nderuar,

Komuna e Kamenicës ka pranuar një Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale bazuar në LIGJI NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS si dhe RREGULLORES (QRK) Nr. 09/2020 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS.

Komuna e Kamenicës në bazë të kërkesës e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për nevojat e SPMK Muçivërc që ta jep në shfrytëzim Objketin e Kërkuar, pasi që Stacioni Policor në fshatin Muçivërc është në gjendje shumë të keqe për shkak të vjetërsisë së objektit, fakt ky i konstatuar edhe nga ana e Inspektorëve Sanitarë, në vizitën e tyre të kryer më datë 12.01.2023, ku kanë konstatuar se qëndrimi i mëtutjeshëm në këtë objekt paraqet rrezik për shëndetin e punonjësve.

Stacioni Policor SPMK Muçivërc ka vizituar disa objekte Komunale që aktualisht nuk shfrytëzohen ku nga alternativat e mundshme, si objekt më i përshtatshëm për nevojat e SPMK Muçivërc e kan zgjedhur objektin e Ambulancës në Fshatin Kopernicë.

Por vlen të theksohet se në Kërkesën e Drejtorisë së përgjithshme të Policisë me nr të referncës 07/1-2/SPMK-M/007/2024, potencohet si Ambulanca në Fshatin Kopernicë, por që objekti nuk është më në shfrytëzim.

Qëllimi i këtijë Arsyetimi është me qëllim të njoftimit me Kërkesën me nr të referncës 07/1-2/SPMK-M/007/2024 së parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për nevojat e SPMK Muçivërc dhe se objekti i Ambulancës në Fshatin Kopernicë nuk është në shfrytëzim.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, të njëjtën praktik e ka përdorur edhe në Qytete tjera me të cilin janë drejtuar me një kërkesë të ngjashme, dhe se është miratuar Ligjshmëria e aktit administativ.

Për sa i përket sipërfaqës së shënuar 4112 m² është sipërfaqe e tërsishme e hapësirës ku edhe ndodhet objekti, prone shoqërore. Shfrytëzimi i hapësirës do të bëhet vetem tek objekti si dhe një pjesë e parcelës që do të shfrytëzohet për parking për vetura zyrtare të Policisë së Kosovës.




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kopërnice



Punoi/Obradio/Created: Jashar

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 12.02.2024

Koha/ Vreme/ Time: 02:03:27



Republika e Kosovës
Republica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107039-00617-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	231/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	12.02.2024 - 13:57
Komuna / Opština / Municipality:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kopërmicë / Kopërmicë / Kopërmicë
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107039-00617-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shpëtorë / Društvena Imovina / Socially owned Land		4112			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FSHAT				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Pojlopjivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjac/pasture	Kulllosë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	3812
2	Bujqësore/Pojlopjivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjac/pasture	Kulllosë E Klasës 6/Pashnjak 6 Klasse/6th Class Pasture	300

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Kamenicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETAS CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. 02	Nr. 3790
U.	Br.
Nr. i faq. 1	Data: 02/02
Br. str.	Datum: 2024
KAMENICË/A	



Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo
Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Lindja Kaçanik
Regionalna Direkcija Granicne Policije Istok Kaçanik
Regional Directorate of Border Police East Kaçanik
SPMK Muçivrcë

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUŽBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: z. Kadri Rahimaj
ZA: Kryetar i Komunës së Kamenicës
TO:

Data:
Datum: 29.01.2024
Date:

PËRMES: Drejtëpërdrejtë
PREKO:
THROUGH:

Nr. i Referencës:
Br. Referencije: 07/1-2/SPMK-M/007/ 2024
Reference No:

PREJ: Kapiten Nazif Hajrizi
OD: Komandant i Stacionit
FROM: SPMK Muçivrcë

LËNDA: Kërkesë për dhënien në shfrytëzim të objektit të Ambulancës së f.sh Kopërnice, për nevojat e
PREDMET SPMK Muçivrcë
SUBJECT:

I nderuari z. Kryetar Rahimaj,

Siç ju kemi njoftuar në takimet e përbashkëta që i kemi mbajtur, gjendja e objektit të SPMK Muçivrcë, është shumë e keqe për shkak të vjetësisë së objektit, fakt ky i konstatuar edhe nga ana e inspektorëve sanitarë, në viziten e tyre të kryer më datë 12.01.2023, ku me procesverbal kanë konstatuar se qëndrimi i mëtutjeshëm në këtë objekt paraqet rrezik për shëndetin e punonjësve.

Falë gatishmërisë suaj për të na ofruar zgjidhjen me dhënien në shfrytëzim të ndonjë objekti komunal që aktualisht nuk shfrytëzohet, ne kemi vizituar disa objekte të tilla ku nga alternativat e mundshme, si objekt më i përshtatshëm për nevojat tona e kemi zgjedhur objektin e **Ambulancës në fshatin Kopërnice**.

Andaj, kërkoj nga ju që si autoriteti më i lartë i Komunës së Kamenicës, të cilës i përket ky objekt, ta aprovoni kërkesën tonë për dhënie në shfrytëzim në një periudhë deri sa të krijohen mundësitë buxhetore që PK të ndërtojë një objekt për nevojat e SPMK-së.

Dyke e qmuar lartë gatishmerin tuaj për bashkëpunim dhe me besimin që kërkesën tonë do ta aprovoni me prioritet, paraprakisht ju faleminderit!

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova–Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107041-01981-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 230/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 12.02.2024 - 13:56
Komuna / Opština / Municipality: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë / Kamenica / Kamenicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107041-01981-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	59260	ndarje parcelë me vendim K.K.Kamenicë nr.1693 date 02-05-12, 124-2003, 117-2004, 1-92, 42-2004, 12-2003, 32-2004, 13-2003, 11-2003, 104-2003, 5-90, 7-90, KERKESË PËR BASHKIM, NR.1693qajqes 03/2015, e dat.03.04.2015, KERKESË PËR PARCELIM, NR.1693qajqes 03/2015, e dat.03.04.2015.	21.04.2015	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
QENDRA TREGTARE ZEJTARE			21.04.2015	

A.2. LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
4	Tokë Ndërtimore/Gradjevinisko zemljište/Construction land	Trrall/Zemljište/Land		59260

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Peshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Indivíduálna Družavina / Single possessor	Komuna e Kamenicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1		22.04.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi i Komunës

Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d), neni 14 paragrafi të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 38 paragrafi 38.1 dhe neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më **.2024 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK - LOKAL “OBJEKTI I SHTËPISË SË KULTURËS “ISA KASTRATI”

1. Me këtë vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 2.1. _____, anëtar i kuvendit
 - 2.2. _____, anëtar i kuvendit
 - 2.3. Visar Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës
 - 2.4. Fadil Hoti, nga ekzekutivi i komunës, dhe
 - 2.5. Sherafedin Vranja, nga sektori joqeveritar lokal.
3. Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme (Lokal "Objekti i Shtëpisë së Kulturës “Isa Kastrati”), me numër të parcelës kadastrale P-71107041-01981-0, përkatësisht pjesët të objektit me numër të parcelës kadastrale O-71107041-01553-0-35-0 kati P- pjesë nga hapësira mbrenda Ndërtesës – Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati” Kamenicë, me sipërfaqe prej 400m², si dhe bodrumi nga e njejta ndërtesë me sipërfaqe 66m², e cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K Kamenicë.
4. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.
5. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (1) një të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien

në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

6. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të kontratës pas lidhjes së sajë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.
8. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Anëtarëve të Komisionit, dhe QSHQ-arkivi.

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 13 dhe nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 46 paragrafi 46.1 dhe paragrafi 46.3 të Statutit Sh.01.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës në pajtim me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), për mbledhjen e mbajtur me datë _____ propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Kamenicë themelon Komitetin për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe përcakton numrin e anëtarëve si në vijim:

1.1. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Lokal i përbërë nga 5 (pesë anëtarë).

-
-
-
-
-
-
-
-

2. Shumica e anëtarëve të komitetit të themeluar sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përbëhen nga anëtarët e kuvendit që duhet të reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit jashtë Kuvendit të Komunës që janë ekspert të fushave përkatëse.
3. Anëtarët e komiteteve tjera për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës, shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme, anëtarët e komiteteve tjera paguhet për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda viti.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës 2 Data: 15/02 2024 Komuna e Kamenicës
Republika Kosovo Datum: Opstina Kamenica
Republic of Kosovo KAMENICË/A Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.12 dt. 14.02.2024

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhënienë në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, sipas nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënienë në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenet 86 dhe 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2024 sjell këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Hydajet Pireva B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës

1. Me këtë vendim “Hydajet Pireva B.I” - (Cetifikata e Regjistrimit: 812093615), me përfaqësues Hydajet Pireva nga Kamenica, i **IPET** në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, prona e paluajtshme e Komunës, sipas procedurës së negocimit.
2. Prona e paluajtshme e Komunës e dhënë në shfrytëzim sipas pikës (1) një të këtij vendimi, është në sipërfaqe prej 70000m², Parcela Kadastrale P-71107041-01075-5 e cila gjendet në Z.K pronë shoqërore Komuna e Kamenicës.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është realizimi i projektit “**Ngritja e Plantacionit me Arrë**” ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrij 141,740.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhoj plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bijë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që “Hydajet Pireva B.I”, fillon me kapacitet të plotë.
